

Albanska

MIRË SE VINI TE

Vizita 5-vjeçare!



Përshëndetje adult!

Fëmija juaj do të fillojë shkollën pak a shumë pas një viti. Gjatë vizitës, së bashku me ju infermierja do të përmbledhë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës nga lindja deri më sot.

Do t'ju dërgojmë një pyetësor që t'i përgjigjeni. Merreni formularin me vete kur të vini.

Jeni ju si prind që dini më shumë për fëmijën tuaj, ndaj gjatë vizitës sigurisht mund të bëni të gjitha pyetjet që doni. Për shembull, pyetjet lidhur me prindërimin, shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, gjumi, ushqimin, vajtjen në banjë dhe mirëqenien tuaj si prind.

Fëmijëve u pëlqen të dinë se çfarë do të ndodhë, njëlloj si ne të rriturve. Me ndihmën e kësaj dosjeje, mund ta përgatitni fëmijën tuaj duke i treguar për vizitën dhe se me çfarë do të përballet fëmija.

Vaksinimi kundër difterisë, tetanozit, kollës së mirë dhe poliometitit ofrohen në vizitë (është vetëm një gjilpërë dhe zakonisht bëhet në muskulin e pjesës së sipërme të krahut).

Nëse e shihni të nevojshme të konsultoheni edhe me një mjek gjatë vizitës, do t'ju duhet të kontaktoni qendrën shëndetësore të fëmijëve kohë para vizitës.

Skanoni kodin QR ose vizitoni faqen e internetit 1177.se/jamtland-harjedalen/barn. Aty gjenden fakte dhe këshilla lidhur shëndetin, zhvillimin, të drejtat dhe kujdesin për fëmijët. Gjithashtu mund të lexohen informacione për prindërimin.



Përshëndetje fëmijë!

Tani është momenti për vizitën 5-vjeçare në qendrën shëndetësore të fëmijëve. Në këtë vizitë, ju dhe prindi juaj do të takoheni me një infermiere.

Ja se çfarë do të bëni gjatë vizitës:

Do të mateni dhe do të peshoheni për të parë se sa jeni rritur që nga vizita e fundit.



Qëndro me një këmbë



Bëj një vaksinë



Vizato dhe prit



Merr një lodër për të luajtur



Numëro





Nëse keni ndonjë pyetje para vizitës, ju lutemi të kontaktoni qendrën shëndetësore të fëmijëve.